

## **Intervistë e Kryesuesit të Misionit të OSBE-së në Kosovë, Ambasador Jean-Claude Schlumberger për RTK 2 “Razgovor”**

**Moderatori:** *Audiençë e nderuar, mirëmbërëma dhe mirë se vini në programin e RTK2. Jeni duke e shikuar emisionin “Razgovor” dhe mysafiri i jonë sonte është Ambasadori Jean-Claude Schlumberger, Kryesues i Misionit të OSBE-së në Kosovë. Zoti Ambasador, mirëmbërëma dhe mirëserdhët në RTK2.*

**Ambasadori Schlumberger:** “Dobro večer” (mirëmbërëma), jam shumë i lumtur që më keni ftuar.

**Moderatori:** *Sa i madh është roli i OSBE-së në integrimin e veriut, duke e pasur parasysh se për organizimin e zgjedhjeve lokale dhe parlamentare ishte e nevojshme ndihma dhe përkrahja e OSBE-së në këtë pjesë të Kosovës?*

**Ambasadori Schlumberger:** Fillimisht dëshiroj të them që OSBE-ja është e pranishme në veri për një kohë të gjatë, që nga fillimi i Misionit, përmes qendrave rajonale dhe zyrës në Mitrovicë veriore dhe zyrave tona të ndryshme në komuna tjera, dhe se kemi zbatuar shumë aktivitete lidhur me shoqërinë civile, rininë, media dhe liderët lokalë në veri. Tani, me marrëveshjen e Brukselit dhe progresin e arritur në dialog, sigurisht që OSBE-ja ka marrë një rol të ri. Ju i përmendët më parë zgjedhjet, lehtësimin e zgjedhjeve në komunat e veriut dhe kjo ka qenë aktiviteti i parë që është dashur ta bëjmë dhe kjo është e shkruar në marrëveshjen e Brukselit gjithashtu. Prandaj, ne kemi organizuar, lehtësuar do thosha unë, grupin e punës ndërmjet përfaqësuesve të Prishtinës/Priştina dhe Beogradit në Bruksel për t’u dakorduar rreth modaliteteve të zgjedhjeve, zbatimit të tyre, dhe përkundër disa problemeve fillestare, në fund vetë procesi doli të jetë i suksesshëm dhe kjo kontribuoi në themelimin e komunave të reja në veri. Prandaj, kjo qe shumë pozitive. Gjithashtu, dëshiroj të përmend që pas kësaj, në qershor, ne lehtësuam zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës, gjë që mundësojë praninë e përfaqësuesve të komunitetit serb në institucionet qendrore. Tani, si rrjedhim nga marrëveshja e Brukselit, ne kemi disa aktivitete zbatuese që, para së gjithash, lidhen me komunat ku jemi duke siguruar trajnime dhe punëtori për anëtarët e kuvendeve komunale. Ne gjithashtu kemi organizuar takime për shkëmbimin e përvojave me komunat tjera. Për shembull, nga komuna e Novo Brdo/NovoBërdës me komunat në veri. Ne po punojmë në aspektin e standardeve ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut, të drejtat e grave, apo në çështjet gjinore. Po ndihmojmë në themelimin e disa grupeve joformale të grave. Në fushën e sigurisë, ne ndihmojmë punën e këshillave komunalë për siguri në bashkësi. Ne gjithashtu kemi rol të rëndësishëm në integrimin e policisë në veri dhe bashkërisht me hisedarët e tjerë, fillimisht ishim pjesë e grupit të

punës për të vlerësuar nevojat e tyre e më pas kemi ofruar trajnime dhe kemi raporte të mira dhe të besueshme me të gjithë komponentët e Policisë së Kosovës në veri. Gjithashtu, bazuar në marrëveshjen e muajit shkurt, ne jemi duke u përgatitur për veprime të caktuara në fushën e gjyqësorit ku do të kemi rol gjithashtu.

**Moderatori:** *Cili është vlerësimi për rrugën e Kosovës drejt BE-së? Sa afër është aktualisht Kosova me BE-në dhe listën e bardhë të Schengenit, bazuar në vlerësimin tuaj?*

**Ambasadori Schlumberger:** Për këtë, besoj që vetë BE-ja dhe shtetet anëtare të saj janë në pozicion më të mirë për t'u përgjigjur se sa unë si përfaqësues i OSBE-së. Vëzhgoj dhe marrë pjesë në disa procese dhe do të thosha që është bërë progres i mirë dhe kjo është dëshmuar qartë me avancimin në Procesin e Stabilizim-Asociimit, i cili, besoj, është në rrugë për t'u nënshkruar në muajt që vijnë. Prandaj, kjo është shumë pozitive. Megjithatë, ka gjëra të tjera për t'u bërë dhe rregulluar dhe Raporti i Komisionit të BE-së tregon që në disa fusha të njohura si qeverisja demokratike, liria dhe profesionalizmi i mediave, fusha e gjyqësorit si dhe korrupsioni ka ende çështje të hapura dhe duhet të them që përmes aktiviteteve të saj OSBE-ja, ashtu si edhe BE-ja, mbështet punën dhe kjo, besoj unë, është shumë e rëndësishme për Kosovën.

**Moderatori:** *Çështjet e pazgjidhura pronësore ende i rëndojnë raportet brenda Kosovës. Fillimisht ishte HABITAT-i, tani është Agjencia Kosovare e Pronës, megjithatë ka vlerësime se nuk po e zgjidhin çështjen e pronave të uzurpuara me shpejtësinë e duhur. Si të sigurohet mekanizmi që do t'ua kthente pronat e uzurpuara pronarëve?*

**Ambasadori Schlumberger:** Po, çështjet pronësore pa dyshim janë të rëndësishme. Dëshiroj ta bëjë të qartë se OSBE-ja nuk merret me çështjet komerciale në kuadër të çështjes së procesit të privatizimit. Ne fokusohemi në pronat private, në veçanti për pronat private të komuniteteve në pakicë numerike. Ky ka qenë fokusi për një kohë të gjatë dhe ne po i monitorojmë këto çështje. Më duhet të them se shumica e çështjeve janë zgjidhur ligjërisht; për shumicën e kërkesave të parashtruara janë nxjerrë vendime nga Agjencia Kosovare e Pronës, ose nga gjyqësori. Kështu që pronarëve legjitim u njihen të drejtat e tyre. Ajo që nuk po funksionon ka të bëjë me riuzurpimin e këtyre pronave, ndonjëherë, edhe kur uzurpuesit e parë dëbohen, ka raste që pronat uzurpohen përsëri. Rishtazi ne kemi publikuar një raport lidhur me të tilla raste dhe është e qartë se në këtë aspekt gjërat nuk po ecin si duhet. Nuk ka bashkëpunim sa duhet ndërmjet Policisë së Kosovës, Agjencisë Kosovare të Pronës dhe gjyqësorit për të mundësuar zbatim të plotë të vendimeve. Kjo është

një çështje që duhet rishikuar dhe për këtë ne jemi duke u dhënë rekomandime përkatëse hisedarëve të ndryshëm.

**Moderatori:** *A është kjo një prej arsyeve që procesi i kthimit nuk po ecën ashtu siç dëshirojmë?*

**Ambasadori Schlumberger:** Është një prej arsyeve. Nuk do të thosha se është arsye madhore, por kontribuon në numrin e ultë të kthimeve. Natyrisht, është brengë, ka edhe të tjera çështje dhe për rrjedhim ka një kontekst të përgjithshëm të mosbesimit, brenga të sigurisë që shpesh i bëjnë të kthyerit të ngurrojnë. Është shumë e rëndësishme që, me rastin e kthimit, të kthyerit ta gëzojnë përkrahjen e komunitetit lokal, të komunës, institucioneve lokale. Ju e dini që ata marrin pjesë në vizitat shko-dhe-shih, kur njerëzit kthehen dhe shohin nëse ka rrethana adekuate për kthim. Kështu që, çështja e pronës është padyshim pjesë e problemit.

**Moderatori:** *Sa realiste do të ishte pritshmëria për sigurim të mjeteve financiare dhe mjedisit për kthimin e personave të zhvendosur në qytete?*

**Ambasadori Schlumberger:** Po, financimi është i rëndësishëm. Kur u takova me ministrin për komunitete dhe kthim më tha që mendonte se buxheti në dispozicion të ministrisë së tij nuk mjaftonte për të adresuar këtë gjë. Kjo do të thotë që nevojiten fonde për të siguruar banim të duhur për personat që kthehen, për sigurim të granteve për aktivitete ekonomike, dhe duhet të them që shumica e zonave me të kthyer nuk është nëpër qytete, janë kryesisht në zona rurale ose gjysmë rurale, kështu që atyre ju nevojiten para për të blerë pajisje bujqësore si traktorë dhe të ngjashëm. Kjo është e rëndësishme por nuk do të thotë që së pari duhet t'i presim paratë e pastaj të nisim me procesin, sepse procesi duhet të vazhdojë sidoqoftë dhe ne duhet të sigurojmë përkrahjen e organizatave ndërkombëtare apo edhe organizatave private të bamirësisë.

**Moderatori:** *Në fund të vitit të kaluar ju ishin një prej organizuesve të takimit rajonal me që për temë kishte kthimin. Mund të thuhet se ishte një hap serioz para në bashkëpunimin ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës/Priştina zyrtare në temën e kthimit.*

**Ambasadori Schlumberger:** Po, takimi që u mbajt në Shkup në muajin nëntor besoj që ishte moment shumë i rëndësishëm sepse bëri të mundur uljen në një tryezë të përfaqësuesve në nivel politik, përfaqësuesve nga Beogradi, Prishtina/Priştina, Shkupi dhe Podgorica, të cilët dëshironin të flisnin seriozisht për një zgjidhje të qëndrueshme për të kthyerit e zhvendosur nga Kosova. Në takim, vërejtja një vullnet vërtetë të fuqishëm nga të gjithë pjesëmarrësit për progres në këtë fushë. Kështu, ata miratuan një deklaratë të përbashkët, një komunikatë të përbashkët që është bërë publike dhe në të cilën përvijohen disa zgjidhje të mundshme në këtë fushë, që nënkupton se personat e zhvendosur në fjalë duhet të gëzojnë dhe t'ju jepet zgjidhja për t'u kthyer këtu ose të ju jepet mundësia për t'u vendosur dhe integruar në vendet ku gjenden aktualisht. Pra

këto janë dy mundësitë dhe ne jemi duke bashkëpunuar ngushtë me UNHCR dhe BE-në në këtë iniciativë sepse ata janë hisedarët më të mëdhenj në çështjen e personave të zhvendosur. Natyrisht, për shkak të zhvillimeve të caktuara politike ka pasur ca ngecje, por tani që e kemi ministrin për komunitete dhe kthim z. Jevtić, në Prishtinë/Priština, shpresoj që do të ndërmerren hapa të reja në periudhën vijuese.

**Moderatori:** *Jemi dëshmitarë të shpeshtimit të sulmeve kundër serbëve dhe pronave të tyre, në veçanti në vendet e kthimit, a mund të lidhet kjo me momentin aktual politik ose...*

**Ambasadori Schlumberger:** Po, ju e dini që ne i monitorojmë këto incidente rregullisht, më lejoni t'i quaj incidente me motivim etnik ose të perceptuara si etnikisht të motivuara. Monitorimin e bëjmë gjatë gjithë vitit, në baza mujore. Konkluzioni i përgjithshëm që do të nxjerrë nga kjo është se nuk ka shtim të rregullt të këtyre incidenteve, përkundrazi ka një rënie që dëshmohet nga monitorimi gjatë dy apo tre vjetëve të shkuara. Por, ka shtim të caktuar të incidenteve në momente të tensionimit politik. Ka dy episode specifike, në fillim të vitit 2013, kur kishim përdhosjen e varrezave që ishte një gjë shumë e keqe dhe që ngriti numrin e incidenteve të shkaktuara, dhe e njëjta ndodhi pas ndeshjes së futbollit në Beograd tetorin e shkuar. Pas incidentit në fjalë, në Kosovë ndodhën shumë incidente të këqija. Do të thosha që kohë pas kohe ka shtim të numrit të incidenteve por përgjithësisht trendi është në rënie. Problemi është se shumica e këtyre incidenteve ndodhin në vende ku komuniteti serb është shumë i izoluar dhe nuk ka raporte të mira me komunitetet tjera. Kjo do të thotë se lë një perceptim të fuqishëm të kërcënimit, të cilin unë e kuptoj dhe ne vërtetë po punojmë me institucionet lokale ashtu që të ketë reagim të duhur të tyre sa herë që të ndodhin incidente të tilla. Duhet që të reagohet në mënyrë përkatëse ndaj incidenteve, të dënohen ato, gjyqësori duhet të merret me to, ashtu që të mos mbeten pa dënimin e merituar. Shpesh ka vjedhje, sulme ndaj shtëpive, ndonjëherë edhe kur janë të braktisura, por fatkeqësisht nganjëherë edhe sulme ndaj personave

**Moderatori:** *Statistikat tregojnë se gjatë dy javëve të fundit janë shënuar tre sulme ndaj personave të kthyer. Çfarë mesazhi jep kjo për ata që mendojnë të kthehen?*

**Ambasadori Schlumberger:** Rreth mesazhit, ky është një proces kompleks dhe ashtu siç thashë është shumë e rëndësishme të punohet me institucionet dhe popullatën e përgjithshme. Prandaj është i rëndësishëm themelimi i këshillave lokalë të sigurisë dhe në komuna janë dy nivele, këshillat komunalë të sigurisë dhe në nivel fshati komitetet lokalë për siguri në bashkësi ku janë përfaqësuesit e komuniteteve të ndryshme, Policia e Kosovës për të ndërtuar raporte të besimit të ndërsjellë dhe për të parandaluar të tilla incidente, por edhe për të punuar në edukimin dhe përcimin e mesazhit tek gjeneratat e reja.

**Moderatori:** *Deputetët e Kuvendit të Kosovës janë para diskutimeve të akteve shumë të rëndësishme ligjore që ndoshta mund të interpretohet në kontekst nëse*

*shumica qeverisëse do ta kenë në fakt shumicën në Kuvend për t'i votuar ato. Po i referohem kryesisht ligjit që do të lejonte themelimin e gjykatës speciale për krime të luftës. Sa e rëndësishme është për Kosovën që të përmbush këtë obligim të marrë nga bashkësia ndërkombëtare?*

**Ambasadori Schlumberger:** Po, siç e dini OSBE-ja nuk është e përfshirë në këtë proces. Kjo lidhet me Këshillin e Evropës dhe BE-në dhe ne po i ndjekim këto zhvillime. Duhet të them se mendoj se është shumë e rëndësishme që të themelohet kjo gjykatë, së pari, ashtu siç e thatë dhe ju, është një obligim ndërkombëtar por kjo gjithashtu do të ishte një mundësi shumë e mirë për pastrimin dhe qartësimin e gjërave. Ende ka familje që pyesin vetën se çfarë ka ndodhur dhe nëse ka ndodhur diçka dhe nëse kjo mund të qartësohet do të çojë në sukses për Kosovën dhe do t'i ndihmojë raportit ndërmjet komuniteteve dhe pajtimit. Prandaj po, në këtë drejtim, ne e mbështesim procesin.

**Moderatori:** *Mund të thuhet që fillimi i bisedimeve në Bruksel ishte, në fakt, një pikë kthese në raportet ndërmjet Prishtinës/Priştina dhe Beogradit.*

**Ambasadori Schlumberger:** Po, mendoj që ishte një hap i konsiderueshëm. Më kujtohet kur erdha këtu për të filluar me detyrë si Kryesues i Misionit të OSBE-së në Kosovë në tetor 2012, në atë kohë zhvilloheshin vetëm disa diskutime teknike, por me angazhimin në dialog të vërtetë politik dhe nënshkrimin e marrëveshjes së Brukselit mendoj që u arrit një hap tejet i rëndësishëm. Kuptohet, gjërat jo gjithmonë janë të lehta dhe gjithmonë do të ketë çështje politike të ngritura. Mund të shihni se disa çështje po vonohen dhe nuk po ecin ashtu si dëshirojmë, por po të shohim anën pozitive, të gjithë këta sektorë që përmenda si komunat, policia, drejtësia, trupat për mbrojtje civile dhe të tjera që janë trajtuar në kuadër të dialogut apo marrëveshjeve teknike është arritur shumë. Politikanët, raportet ndërmjet politikanëve, liderëve nga Prishtina/Priştina dhe Beogradi kanë ndryshuar tërësisht që kur diskutuan për nevojat. Ata mblidhen në Evropë dhe diskutojnë dhe ky është ndryshim i madh. Duhet të jemi optimist sepse është shumë e rëndësishme që kemi mbështetjen e popullatës për këtë proces, në të dyja anët.

**Moderatori:** *Këtë vit Serbia është kryeson me OSBE-në, sa e dobishme mund të jetë kjo për Kosovën në këtë kohë, ashtu që disa çështje të rëndësishme të hyjnë në agjendën e OSBE-së më shpejtë?*

**Ambasadori Schlumberger:** Po. Ju e dini që kryesimi është vjetor. Çdo vit njëri prej shteteve pjesëmarrës merr përgjegjësinë e përfaqësimit të 57 shteteve pjesëmarrëse të OSBE-së dhe këtë vit i takon Serbisë. Kjo nuk e ndryshon kontekstin, me tjera fjalë, rregullat në OSBE mbesin ato që janë, është organizatë konsensuale. Mandatet e misioneve nuk ndryshojnë, dhe kjo vlen edhe për

misionin në Kosovë, por edhe për misionet e tjera simotra, pavarësisht nga fakti se kryeson Serbia apo ndonjë vend tjetër. Kjo nuk i ndryshon gjërat. Shpresoj që të jetë një mundësi për adresimin e disa çështjeve, në frymën e dialogut, të cilat janë pjesë e vlerave të OSBE-së dhe shpresoj që të kemi sukses në këtë drejtim.

**Moderatori:** *Në Maqedoni (IRJM) ndodhi ajo që ndodhi. Disa persona u vranë në Kumanovë. Si e sheh OSBE tërë këtë situatë? A jeni të brengosur për ngjarjet e fundit në IRJM?*

**Ambasadori Schlumberger:** Patjetër që jemi të brengosur për stabilitetin e fqinjit jugor, por gjithashtu edhe për gjendjen e përgjithshme në rajon. Këto që ndodhën janë ngjarje jashtëzakonisht shqetësuese dhe fatkeqe. Kuptohet, Misioni i OSBE-së në Shkup ka qenë mjaft i angazhuar në këtë çështje, dhe është pjesë e mandatit të Misionit atje që të merret veçanërisht me çështje ndëretnike, ndërsa Misioni i jonë është mobilizuar dhe po përpiqemi të ju ndihmojmë në mënyra të ndryshme meqë jemi edhe shumë afër.

**Moderatori:** *A ekziston mundësia që, kur flasim për zonat ku ka tensione, situata në Ukrainë të reflektohet në Kosovë në kontekst të vazhimit të Misionit në Kosovë dhe frikës që Rusia mund të përdorë ndikimin e saj kur duhet vendosur në këtë çështje?*

**Ambasadori Schlumberger:** Epo, është e qartë se kriza në Ukrainë ka marrë primatin në OSBE, dhe se e tërë, gjegjësisht shumica e energjisë është drejtuar kah Ukraina. Meqë OSBE-ja është e vetmja organizatë ndërkombëtare e pranishme në terren atje, ndonjëherë ka edhe situata të rrezikshme dhe numrat dhe prania e jonë atje po rritet. Shumë shpejtë do të jetë Misioni më i madh i OSBE-së që është vendosur ndokund. Prandaj, kjo gjithashtu nënkupton që këtij Misioni i nevojiten mjete për të punuar, qofshin këto mjete financiare ose logjistike, apo resurse njerëzore. Ne si Mision e kemi dhënë kontributin tonë duke i dërguar disa punonjës tonë atje për kohë të shkurtër, por gjithashtu disa prej tyre që rekrutohen atje. Po ashtu kemi dërguar automjete për të ndihmuar në këtë drejtim dhe është e mundur që kjo barrë mund të sjellë edhe deri tek marrja e disa resurseve të tjera nga Misioni i ynë. Por sidoqoftë, do të thosha që pakësimi i mjeteve për Misionin tonë është fenomen normal gjatë viteve sa jemi këtu. Ndërkohë që ju vazhdoni t'i merrni sipër punët në Kosovë, kurse ne vetëm ju përkrahim dhe shohim që ka progres në sektorë të ndryshëm, natyrisht se do t'i dorëzojmë tek vendorët. Ne po përqendrohemi tani në disa sektorë specifikë dhe me kalimin e kohës do të ketë zvogëlim të rregullt të pranisë sonë. Ashtu siç e kam diskutuar këtë çështje me liderë dhe hisedarë të ndryshëm, që nga arritja

ime këtu, mund të shohim se ende ka sektorë ku mbështetja e jonë është e mirëseardhur dhe e dobishme dhe sigurisht që ne jemi të gatshëm ta ofrojmë atë.

**Moderatori:** *Nga pikëpamja e Kryesuesit të Misionit të OSBE-së në Kosovë, si do ta vlerësonit lirinë e mediave?*

**Ambasadori Schlumberger:** Ka disa indikatorë që nuk janë produkt i yni por që vijnë nga grupe të specializuara dhe raporte që ju i keni lexuar si ai i Freedom House që e rangon Kosovën si pjesërisht të lirë sa i përket mediave. Nëse nuk gaboj, ishte në vendin e 97 nga gjithsej 1091 vende. Pra diku në mes të listës, meqë ende ka çështje për t'u zgjidhur. Siç e dini, që nga fillimi i pranisë së tij në Kosovë, Misioni i OSBE-së ka punuar me mediat. Ju e dini se si ne kemi kontribuar për krijimin e mediave këtu dhe rishtazi kishim një konferencë, tryezë për Ditën e Lirisë së Mediave, dhe aty u tha qartë se ende ka probleme, në veçanti ndërhyrje politike, çështje financiare që janë të rëndësishme për qëndrueshmërinë e mediave dhe institucioneve të mediave. Por ka edhe shumë kërcënime ndaj gazetarëve, shifrat në këtë drejtim nuk flasin për të mirë dhe kemi vërejtur shumë kërcënime kundër gazetarëve të ndryshëm. Më duhet të them gjithashtu se ka gazetarë të cilët janë shumë profesionistë dhe e kryejnë detyrën e tyre e madje edhe i adresojnë këto kërcënime ndaj tyre.

**Moderatori:** *A mund ta ndihmojë OSBE-ja transmetuesin publik, RTK2, programin në gjuhën serbe në mbulimin e tërë territorit të Kosovës me sinjal?*

**Ambasadori Schlumberger:** Po,. Ne jemi vërtetë të përfshirë në këtë proces për të ndihmuar sa është e mundur. Duhet të jetë e dyanshme kjo. Është e qartë se po punojmë ose po i ndihmojmë mediave që të kemi dakordimin e shërbyesve kabllorë të transmetojmë kanalin tuaj RTK2 normalisht në veri, por në të njëjtën mënyrë duhet që televizionet nga veriu të kenë të njëjtën mundësi transmetimi në jug. Kjo është e rëndësishme dhe mendoj se jemi në një proces të mirë dhe se do të kemi rezultate pozitive në një kohë jo shumë të largët. Këto janë informacionet e fundit që kemi nga diskutimi i jonë me operatorët kabllorë.

**Moderatori:** *Roli i OSBE-së në Kosovë ka ndryshuar nga viti 199 e deri më sot, cilat janë sfidat që prisni t'i hasni në të ardhmen?*

**Ambasadori Schlumberger:** PO. Pikërisht kështu e ka OSBE-ja, në përgjithësi për misionet e ndryshme të saj kudo, që secili Mision ka mandatin e tij dhe ne kemi mandatin që nga viti 1999. Por, është e qartë se zbatimi i mandatin ndryshon me përputhje me ndryshimet e situatës, lokalisht dhe përgjithësisht. Kjo ka ndodhur edhe në rastin tonë. Kur shoh se si ka vepruar Misioni në pesë vitet e para pas vendosjes këtu dhe se si punon tani shihet qartë ndryshimi. Ka pasur një

evolucion dhe mund të them që qëllimi jonë është të fokusohemi në disa sektorë specifik, qeverisje lokale, sepse kemi punuar mjaft në qeverisje qendrore duke ndihmuar në ndërtimin e institucioneve, por tani në nivelin lokal, gjegjësisht komunal, të performancës po punojmë dhe, meqë jemi të pranishëm në tërë territorin e Kosovës, kjo prani e jona mund të ndihmojë. Pastaj, mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të komuniteteve është diçka shumë e rëndësishme për hapat e më tutjeshëm, duke i përfshirë këtu edhe gjërat e natyrshme si trashëgiminë kulturore dhe të drejtat e komuniteteve të tjera që duket respektuar, pastaj mediat, për të cilat folëm më herët, pra këto janë disa pika ku mendoj se ende nevojitet veprimi jonë me fokus më të fuqishëm. Pastaj, natyrisht, ka edhe fusha të tjera për të cilat mendojmë, siç është policia. Ju e dini se, siç do të thosha unë, që nga themelimi ne e kemi ushqyer Policinë e Kosovës, e veçanërisht Akademinë e Kosovës për Siguri Publike, të cilën e kemi përkrahur dhe tani kemi mjaft për të përkrahur në ato gjëra që nuk shkojnë mirë. Prandaj, tani kemi veprime shumë më të fokusuar dhe të specializuara se sa në kohën e pranisë së madhe më parë. Ky, mendoj unë, do të jetë trendi i përgjithshëm në të ardhmen.

**Moderatori:** *Zoti Ambasador, ju falënderoj shumë për kohën që ia kushtuat RTK2 dhe audiencës tonë.*

**Ambasadori Schlumberger:** Ishte kënaqësi.

**Moderatori:** *Audiençë e nderuar, ju faleminderit për vëmendjen tuaj dhe qëndroni me RTK2. Mirupafshim.*